

FJALA
E KRYETARIT TË KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT
Z. ARBEN SHEHU NË SEANCË PLENARE
TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Mbi

**Raportin e veprimtarisë vjetore të Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin
2020**

**I nderuar Zoti Kryetar i Kuvendit,
Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,**

Kam kënaqësinë t'Ju paraqes raportin vjetor të veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2020.

Të gjithë jemi dëshmitarë që viti 2020 ishte një vit i trazuar dhe shumë i vështirë, në një situatë të pazakontë të pandemisë botërore COVID-19, e cila ashtu si në të gjitha institucionet e tjera publike brenda dhe jashtë vendit, ka ndikuar edhe në veprimtarinë institucionale të institucionit tonë.

Pavarësisht sfidave, Kontrolli i Lartë i Shtetit, si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili auditon në përputhje me Kushtetutën, kuadrin ligjor, rregullator dhe manualet në fuqi, ka marrë të gjitha masat për të vijuar punën pa ndërprerje me përgjegjshmëri dhe rigorozitet duke arritur të plotësojë dhe zbatojë detyrimet kushtetuese.

Edhe gjatë vitit 2020, Kontrolli i Lartë i Shtetit si institucion i pavarur, i cili informon në vazhdimësi, dhe në mënyrë të paanshme Kuvendin e Shqipërisë, i ka përmbushur detyrimet kushtetuese.

Në funksion të mirëqeverisjes, KLSH-ja ka informuar Kuvendin edhe përmes raporteve të cilat paraqesin rëndësi për taksapaguesit dhe publikun e gjerë. Konkretisht gjatë vitit 2020, Kontrolli i lartë i Shtetit i ka përcjellë Kuvendit të Shqipërisë 66 vendime dhe raporte për auditimet e kryera, si dhe në përmbushje të detyrimeve, KLSH ka informuar Kuvendin e Shqipërisë mbi statusin e implementimit të rekomandimeve të lëna në institucionet e audituara.

Në këtë kuadër, rezultatet e auditimeve të kryera gjatë vitit 2020, kanë evidentuar problematikat e menaxhimit të fondeve, aseteve dhe pasurisë publike, si dhe përgjegjësitë përkatëse nga zyrtarët e çdo niveli të qeverisjes qendrore, vendore dhe enteve në varësi të tyre.

Gjithashtu, KLSH gjatë veprimtarisë audituese, në mënyrë të vazhdueshme ka pasur qasjen që të nxisë dhe të thellojë transparencën, përgjegjshmërinë,

Ilogaridhënie, forcimin e disiplinës fiskale dhe rritjen e efikasitetit në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve publike me qëllim ofrimin e shërbimeve të përmirësuara dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

Duke i kushtuar vëmendje të veçantë ruajtjes së qëndrueshmërisë në rezultatet e arritura, konkretizimit të qëllimeve strategjike, përmirësimit të kuadrit rregullator dhe metodologjik, optimizimit të kapaciteteve profesionale, si dhe përmirësimit të kanaleve të komunikimit dhe bashkëpunimit, veprimtaria e Kontrollit të Lartë të Shtetit edhe për vitin 2020, është konkretizuar në tre qëllime strategjike konkretisht:

1. Rritja e impaktit të punës audituese me fokus 6E-të (Efektiviteti, Eficienca, Ekonomiciteti, Etika, Energjia dhe Mjedisi);
2. Optimizimi i kapaciteteve profesionale, aftësive audituese, procedurave të punës, logjistikës dhe funksioneve të tjera mbështetëse;
3. Përmirësimi i kanaleve të komunikimit dhe bashkëpunimit.

Në këtë kuadër, KLSH, duke ecur përkrah SAI-eve partnere, është përpjekur në mënyrë të vazhdueshme për rritjen e profesionalizmit auditues, në përshtatje me ritmin e zhvillimit ekonomik dhe social të vendit, si dhe të modernizimit të institucionit.

Për sa i përket përmirësimit të kanaleve të komunikimit dhe bashkëpunimit, përfitoj nga rasti të falënderoj Kuvendin e Shqipërisë për bashkëpunimin në rritje me Kontrollin e Lartë të Shtetit. Në cilësinë e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit (dhe të institucionit që unë drejtoj), falënderoj Komisionin e Ekonomisë dhe Financave, kryetarin e këtij Komisioni në mënyrë të veçantë, si dhe deputetët anëtarë, për vëmendjen që i kanë kushtuar institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe ndihmesës së dhënë në përmirësimin e funksionimit institucional të KLSH-së.

Në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit 2018-2022, KLSH-ja ka ndërmarrë veprime për të përmirësuar kapacitetin institucional, si dhe forcimin e ligjit organik.

Raport me rëndësi të veçantë për institucionin tonë është dhe Raporti i progresit të Komisionit Evropian publikuar në tetor 2020 për Kapitulli 32 “Kontrolli Financiar”, ku veprimtaria e KLSH-së është vlerësuar “në përputhje me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit kuadri kushtetues dhe ligjor parashikon pavarësinë e KLSH-së”.

Raportin e Progresit të Komisionit Evropian, KLSH-ja e ka konsideruar tejet të rëndësishëm për ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe përafrimin e veprimtarisë së tij me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe praktikat më të mira evropiane. Për zbatimin e rekomandimeve që rrjedhin nga ky raport politikat menaxheriale u sintetizuan në Planin e Veprimit mbi rekomandimet e KE-së për KLSH-në.

Pesë rekomandimet e Raportit të Progresit do të implementohen nëpërmjet përbushjes së 12 veprimeve konkrete të cilat kanë në fokus:

- Propozimin e përsëritur të Kontrollit të Lartë të Shtetit drejtuar Kuvendit të Shqipërisë për ngritjen e një nënkomisioni parlamentar, pjesë e Komisionit për Ekonominë dhe Financat për shqyrtimin e raporteve të KLSH-së;
- Propozimin e përsëritur të KLSH-së drejtuar Kuvendit të Shqipërisë për nënshkrimin e një memorandumit mirëkuptimi midis dy institucioneve dhe hartimi i një plani konkret pune për rritjen e kontrollit parlamentar për implementimin e rekomandimeve të KLSH-së;
- Përcjelljen në Kuvendin e Shqipërisë të propozimeve për amendimin e Ligjit nr. 154/2014 “Për funksionimin dhe organizimin e KLSH-së”;
- Hartimin dhe zhvillimin e një plani specifik trajnimesh, i cili ka në fokus zbatimin e kërkesave të Standardit ISSAI 140 “Kontrolli dhe Sigurimi i Cilësisë” dhe implementimin praktik të Udhëzuesit për Menaxhimin e Cilësisë së Auditimit në kontekstin e implementimit të Rregullores së rishikuar të Procedurave të Auditimit dhe manualeve të rishikuara për auditimet financiare, të përputhshmërisë dhe performancës, si dhe manualit të ri për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, dokumente këto të miratuara në qershor 2020;
- Forcimin e kapaciteteve audituese të KLSH-së për auditimin e kontratave dhe implementimin e PPP nëpërmjet trajnimit të audituesve, hartimit të udhëzuesve të posaçëm për të ndihmuar audituesit në auditimin e PPP-ve dhe rritjen e nivelit të cilësisë së auditimeve;
- Përcjelljen në Kuvendin e Shqipërisë të raporteve periodike dhe raportit të konsoliduar mbi ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së;
- Krijimin nga ana e Sekretariatit të Përbashkët KLSH-MFE të mekanizmave efektivë për të siguruar rritjen e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të auditimit si pjesë e marrëveshjes së Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
- Kryerjen e trajnimeve në drejtim të njohjes së legjislacionit të prokurimit publik dhe zbatimin e manualit të auditimit të Prokurimeve, si dhe pjesëmarrjen e audituesve të KLSH-së në trajnimet që kryhen nga SAI-t homologe në drejtim të auditimit të prokurimit publik.

Lidhur me rezultatet e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2020 si një vit i vështirë dhe i paprecedentë, ka vijuar puna audituese për përgatitjen e 145 raporteve të auditimit, nga të cilët janë evaduar 73 auditime.

Auditimet e evaduara përbëhen nga 5 auditime financiare me dhënie opinionit, 28 auditime përputhshmërie, 16 auditime rregullshmërie, 11 auditime tematikë, 9 auditime performance dhe 4 auditime të Teknologjisë së Informacionit.

Auditimet e kryera nga KLSH kanë përfshirë vlerësimin e aktivitetit ekonomik dhe financiar në 91 subjekte si institucione qendrore, ministri dhe agjenci (përfshirë drejtori qendrore dhe rajonale në varësi të tyre), njësi të vetëqeverisjes vendore (qarqe, bashki), drejtori të përgjithshme të administrimit fiskal, fonde speciale, si dhe shoqëri aksionare.

Janë evaduar auditimet e ushtruara në 76 subjekte, rezultatet e të cilëve kanë evidentuar shkelje me efekte të konsiderueshme në buxhetin e shtetit, lidhur me administrimin e të ardhurave; menaxhimin joefektiv në përdorimin e fondeve publike; keqadministrimin e pronës publike, e ndjekur nga paligjshmëritë në realizimin e procedurave të prokurimit publik dhe zbatimin e kontratave.

Duhet theksuar se me gjithë vështirësitë objektive të krijuara nga situata e pandemisë, KLSH është përpjekur maksimalisht të ruajë trendin në rritje të peshës specifike të auditimeve financiare dhe atyre të performancës ndaj totalit të auditimeve.

Kështu në vitin 2020 janë dhënë opinione financiare për 22 % të auditimeve nga 16 % në vitin 2019. Në 16 auditimet e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë klasifikuar si auditime të kombinuara janë dhënë opinione për pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë për 12 auditime. Në këtë mënyrë KLSH synon zbatimin në vazhdimësi të rekomandimit të Komisionit Evropian në Raportet e Progresit për Shqipërinë për rritjen e përqindjes së auditimeve financiare dhe të performancës ndaj llojeve të tjera të auditimeve.

Rezultatet e punës audituese të vitit 2020 kanë pasur objektiv dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes së institucioneve të audituara nëpërmjet masave organizative, si dhe identifikimin e shkeljeve me pasoja dëm ekonomik dhe/ose parregullsi/paligjshmëri me efekte negative në financat publike. Ndër treguesit kryesorë të performancës së aktivitetit të KLSH-së, për vitin 2020 përmendim:

- ✓ **Adresimin në total prej 1430 rekomandimeve**, nga të cilat: 29 janë propozime për përmirësime ligjore, 1107 masa organizative, dhe 294 rekomandime për masa disiplinore dhe administrative.
- ✓ **Shkelje me pasojë dëm ekonomik** - Parregullsi dhe shkelje financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, me dëm ekonomik **në shumën totale rreth 2.2 miliardë lekë ose rreth 17.7 milionë euro**.
- ✓ **Parregullsitë dhe paligjshmëritë me efekte negative** - Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në shumën 85.9 miliardë lekë (**ose afërsisht 694.1 milionë euro**) nga e cila: 11.4 miliardë lekë në fushën e të ardhurave (**ose afërsisht 91.9 milionë euro**), dhe 74.5 miliardë lekë (**ose afërsisht 602.2 milionë euro**), në fushën e shpenzimeve.

Sa i takon **menaxhimit të financave publike**, edhe gjatë vitit 2020 KLSH ka vijuar të sjellë në vëmendje, risqet e identifikuara për miradministrimin e financave publike dhe zbatimin e kontrolleve të parashikuara të disiplinës fiskale. Nëpërmjet rekomandimeve të lëna, institucioni ka kërkuar adresimin e menjëhershëm dhe të kujdesshëm të mbajtjes në kontroll dhe monitorim të treguesve fiskalë dhe makro-ekonomikë, më konkretisht:

1. Në lidhje me raportimin e nivelit të defiçitit për vitin 2019
2. Në lidhje me planifikimin më të drejtë të të ardhurave tatimore sipas zërave të vecantë dhe shpërndarjes së tyre në rajone në korelacion me grup-tatimpaguesit, kapacitetet dhe zhvillimet rajonale.
3. Në lidhje me një vlerësim më relevant dhe transparent të impaktit në të ardhurat tatimore i ndryshimeve të parashikuara në legjislacionin tatimor, në përputhje me parimet dhe rregullat fiskale.

Në lidhje **me auditimet financiare**, veprimtaria audituese e KLSH-së gjatë vitit 2020, është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit Financiar (ISSAI 2000-2899), si dhe Manualit të auditimit financiar, i cili gjithashtu është rishikuar dhe do të nisë zbatimin e plotë gjatë vitit 2021.

Gjatë vitit 2020, KLSH-ja ka kryer dhe evaduar 5 auditime financiare ose 7% ndaj totalit të auditimeve të evaduara, për të cilat janë dhënë 2 opinione të kualifikuar, 1 i pakualifikuar, 1 me theksim të çështjes dhe 1 opinion i kundërt.

Gjatë viti 2020, KLSH-ja ka kryer 28 **auditime përputhshmërie**.

KLSH, duke qenë në sinkron dhe në zbatim të rekomandimeve të Komisionit Evropian për auditimin e jashtëm të sektorit publik të viteve të fundit ka synuar rritjen e përqindjes së numrit të **auditimeve të performancës ndaj auditimeve**

gjithsej. Kështu gjatë vitit 2020 janë kryer dhe evaduar 9 auditime performance të kryera në 28 subjekte, të cilat përfaqësojnë 12.5 % të auditimeve gjithsej, kundrejt 11.4 % në vitin 2019.

Bashkëpunimi i KLSH-së në luftën kundër korrupsionit për vitin 2020 krahas nënshkrimit të marrëveshjeve specifike të bashkëpunimit, është intensifikuar nëpërmjet marrëdhënieve të bashkëpunimit me institucionet ligj-zbatuese si Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria Speciale, Byroja Kombëtare e Hetimit, SPAK etj.

Ngritja dhe forcimi i kapaciteteve institucionale ka vijuar duke u mbështetur në trajnimin e audituesve, konsideruar nga KLSH si një proces investimi strategjik i kohës, energjisë dhe burimeve, në përmirësimin e kapaciteteve audituese. Gjatë vitit 2020, për shkak të situatës së shkaktuar nga Covid-19, trainimet nga institucioni apo nga partnere brenda dhe jashtë vendit janë përshtatur dhe ofruar nëpërmjet platformave online, me qëllim përmbushjen e objektivave në lidhje me zhvillimin profesional.

Gjatë vitit 2020, KLSH i ka kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve të komunikimit dhe të transparencës.

Kontrolli i Lartë i Shtetit është përpjekur të rrisë influencën dhe impaktin e auditimeve, duke zgjeruar bazën e përdoruesve, në mënyrë që gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e auditimeve, t'i shërbejnë në mënyrë cilësore publikut, duke përdorur kanalet më efektive të komunikimit.

Komunikimi dhe bashkëpunimi me median vijon me të njëjtën frymë dhe intensitet duke rritur në këtë mënyrë transparencën e veprimtarisë së KLSH-së.

Gjej rastin të falënderoj mediat për mbështetjen e vazhdueshme që i kanë dhënë institucionit tonë.

Edhe angazhimi i KLSH-së në aktivitete dhe botime për vitin 2020 nuk është ndërprerë ndonëse lindi nevoja e përshtatjes me rrethanat e krijuara nga pandemia. Në këto kushte, 6 botimet e KLSH-së, janë të publikuara në faqen online.

Gjatë vitit të shkuar ka filluar gjithashtu edhe pilotimi i këtyre manualeve, proces që po vijon edhe për vitin 2021, për të garantuar një informacion më të hollësishëm lidhur me cilësinë e punës audituese.

Duke ju falënderuar edhe njëherë për vëmendjen që Kuvendi kushton ndaj Kontrollit të Lartë të Shtetit, e cila dëshmohet më së miri dhe me mbajtjen e kësaj

interpelance, përsëris në mënyrë të vazhdueshme nevojën dhe kërkesën e institucionit tonë për ngritjen e një nënkomisioni parlamentar, pjesë e Komisionit për Ekonominë dhe Financat për shqyrtimin e raporteve të KLSH-së dhe zhvillimin në mënyrë periodike të dëgjësave parlamentare për vlerësimin e veprimeve korrigjuese të ndërmarra nga institucionet e audituara për implementimin e rekomandimeve të KLSH-së.

**I nderuar Zoti Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë,
Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,**

KLSH po vijon dhe do të vijojë për periudhën e mbetur të këtij viti, të kryejë auditime profesionale bazuar në parimin e integritetit si dhe në zbatim të kuadrit ligjor kombëtar, korpusit të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t dhe praktikave më të mira të fushës.

Edhe njëherë Ju faleminderit për vëmendjen dhe mbështetje e vazhdueshme!